



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Fier, më __.04.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Blerje pajisje mobilerie per shkollen “Naim Frasheri,Fier”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Tavolina 39121200-8, Dollapë dhe rafte librash 39122000-3, Karrige 39112000-0,

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,725,717 (Tete milion e shtateqind e njezet e pese mije e shtateqind e shtatembedhjete) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi:Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të ligjit nr.162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,ne të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2022, 2023**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **3 000 000 (tre milion) lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.Pika2/c: 2. Vlera e xhiros

minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% te vlerësse parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirine ulët monetar;

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperem eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c)40% te vlerës se parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirine ulët monetar;* Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit nen kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme percaktimin e dy viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te parashikuar.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **1 600 000 (nje million e gjashteqind mije leke) leke pa TVSH (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet)**, që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

- a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **1 600 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikën 4 të nenit 40 dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci 2(dy) vjecare për mallrat e ofruar nga momenti i marrjes në dorëzim, si dhe ndërrimin në raste defektesh nëpërmjet një deklarate për periudhën e garancisë, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë edhe riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklarate se merr përsipër të realizojë furnizimin e mallrave objekt prokurimi (përfshirë kryerjen e shërbimit të transportit dhe montimit të të gjithë artikujve në ambientet e brendshme të Autoritetit Kontraktor

(Shkolla 9-Vjecare “Naim Frasheri”, Fier), sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një katalog ku të shënohet në mënyrë të qartë modeli i ofruar per te gjitha zerat e parashikuar ne preventiv.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në gërmën b të pikës 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” , i ndryshuar. Ky kriter kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi, funksionalitetit dhe jetëgjatësisë së mallrave objekt prokurimi.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (në gjuhën shqipe ose të përkthyer/ noterizuar), si më poshtë:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë ose ekuivalente (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” . Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësisë, e cila mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetin e mëposhtëm:

- Mjet me kapacitet mbajtës **mbi 3.5 ton** **copë 1**

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose qera (me kontratë noteriale), duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatën e pronësisë,
- siguracionin e mjetit,
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit te paraqitur. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
 - fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.
- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat e kërkuara objekt prokurimi. Ne rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar. Secili nga dokumentat duhet te përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave si dhe origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 5/a dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe argumentuar nga grupi i punës i ngritur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e cila ka derguar dokumentacionin në Bashkinë Fier me shkresë nr.1668/16 prot date 07.03.2024 (Tirane) dhe protokolluar në Bashkinë Fier me shkresë nr.2521 prot., datë 08.03.2024 me lende «Per blerjen e pajisjeve të mobilerise per shkollat e arsimit baze dhe te mesem» si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Shenim: Referimet ku në specifikime janë përmendur marka / produkte / origjinë, shoqërohen me fjalën “ose ekuivalente”.

Shenim: Në rast ku është përdorur emri i markes/ produkte / origjinë në tabelën e preventivit me zerat dhe sasitë e mallrave, përfshihet edhe termi “ose ekuivalente me të”.

Kriteret teknike të veçanta të kualifikimit pikat (2.3.2, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7) janë hartuar e argumentuar nga specialisti i fushës me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor me nr.4039 prot date 08.04.2024 .

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT :